



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 20436 prot.

Lezhë, më: 30.12. .2024

PROJEKT-V E N D I M

NR. _____, Datë _____, 2024

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI PRIVATE, PËR NDËRTIM OBJEKTI ME FUNKSION; KOMPLEKS TURISTIK, RESORT ME SUITA 1, 2, 3, 4 DHE 5 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËN TOKË NGA SHOQËRIA "PRINCE ADRIATIK RESORT" SHPK DHE SHOQËRIA "PRINCE JUNIOR SHPK"

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **0.99 ha** pyll në pronësi private, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur. Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjor kombëtar detajohet si mëposhtë:
 - **0.3 ha** pyll në pasuritë 1000/35 dhe 1004/2 zona kadastrale 2568, ngastra pyjore 62a, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
 - **0.69 ha** pyll në pasuritë 1004/2 dhe 1004/4 zona kadastrale 2568, ngastra pyjore 62c, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".

2. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore të dëmtuar jashtë pjesës ku do të ndërtohet, bëhet nga shoqëritë “**PRINCE ADRIATIK RESORT**”sh.p.k dhe “**PRINCE JUNIOR**” sh.p.k brenda 1 (një) viti nga koha e përfundimit të objektit.
3. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

KRYETARI

Pjerin NDREU

